

VENDIM
Nr. 229, datë 23.4.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR TRANSFERIMIN E MBETJEVE JO TË RREZIKSHME DHE INFORMACIONIT QË DUHET TË PËRFSHIHET NË DOKUMENTIN E TRANSFERIMIT

(Ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020; nr. 526, datë 1.8.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11 të nenit 21 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për transferimin në mënyrë profesionale të mbetjeve jo të rrezikshme nga një person te një tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit.

2. *Mbetje jo të rrezikshme klasifikohen mbetjet që nuk shënohen me shenjë yll "*", të miratuara me vendimin nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve", të cilit më poshtë i referohemi me emërtimin "Katalogu i mbetjeve".*

3. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

4. Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet sipas formatit të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme, të përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme plotësohet për të gjitha hallkat që ndiqen për transferimin e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar.

6. Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme plotësohet dhe nënshkruhet nga krijuesi i mbetjeve, grumbulluesi, transportuesi dhe pritësi që merr në dorëzim mbetjet, sipas aneksit 1 bashkëlidhur, në aq kopje sa janë personat që nënshkruajnë dokumentin.

7. Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme është i vlefshëm edhe në formë elektronike, nëse është i plotësuar dhe i nënshkruar nga personat e përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Përfshihet nga procedura e zbatimit të këtij vendimi vetëm gjenerimi i mbetjeve shtëpiake.

9. Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet në bazë të kontratës ndërmjet palëve, në të cilën përcaktohet detyrimisht përgjegjësia për rastin e kthimit mbrapsht, pjesërisht ose plotësisht, të mbetjeve nga pritësi, duke plotësuar seksionin C të aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Çdo transfertë e mbetjeve jo të rrezikshme shoqërohet me dokumentin e transferimit të mbetjeve deri në destinacionin përfundimtar dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertave Individuale që krijohet për këtë qëllim.

11. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon Regjistrin Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme.

12. Mënyra e administrimit dhe formati i Regjistrit të Transfertave Individuale dhe formati i Regjistrit Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

13. *Krijuesi, grumbulluesi dhe pritësi i mbetjeve raportojnë në mënyrë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania", pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, informacion lidhur me mbetjet jo të rrezikshme të transferuara, referuar dokumentit të transferimit, të paktën 1 (një) herë në 6 muaj.*

14. *Dokumenti i transferimit përmban kodin unik, i cili përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë e kodit unik miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit pas paraqitjes së kërkesës, nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania", nga personi që transferon mbetjet jo të rrezikshme tek pritësi. Agjencia Kombëtare e Mjedisit shqyrton kërkesën dhe verifikon të dhënat e kërkuarit nga ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe licencën III.2.B. Në rast se nga verifikimi konstatohet se dokumentacioni i depozituar nga kërkuari nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit unik qeveritar "e-Albania", duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të kërkuar brenda këtij afati përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Kërkuari njoftohet përmes portalit unik qeveritar "e-Albania" për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet.*

15. *Agjencia Kombëtare e Mjedisit miraton pjesën e parë të Kodit Unik brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania".*

16. Pjesa e parë e kodit unik është individuale dhe e papërsëritshme për çdo subjekt që transferon mbetje jo të rrezikshme, ndërsa pjesa e dytë e këtij kodit vendoset nga vetë personi që transferon mbetjet te pritësi dhe ndryshon për çdo transfertë.

17. Përcaktimi i kodit unik bëhet sipas metodologjisë së dhënë në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

18. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon dhe administron një bazë të dhënash për kodet unike. Baza e të dhënave shërben si pjesë e Regjistrat Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme, që mban Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Baza e të dhënave për kodet unike përmban elementet e mëposhtme:

a) institucionin administrues, Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

b) të dhënat parësore, si: lloji i mbetjes, kodi i mbetjes sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve, gjendja/forma fizike e mbetjes (e gaztë/ e lëngët/ e ngurtë/ pluhur/ llum/ përzier);

c) të dhënat dytësore, si: numri i regjistrimit, NIPT-i, numri i identifikimit të lejes së mjedisit, numri i identifikimit të licencës III.2.B;

ç) dhënësit e informacionit, si personi fizik/juridik, QKB-ja;

d) ndërveprimi QKB–Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

dh) personat e interesuar, si personi fizik/juridik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

19. Mospërbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim dhe në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

19/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, raportimi i informacionit lidhur me mbetjet jo të rrezikshme të transferuara bëhet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

20. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Aneksi 1

Formati i dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020)

Për t'u përdorur për transferimin vetëm të mbetjeve jo të rrezikshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Seksioni A. Krijuesi i mbetjeve/grumbulluesi/NjQV-ja/Transportuesi/Agjenti/Tregtari			
Kodi unik i dokumentit të dorëzimit (për t'u plotësuar nga krijuesi i mbetjes)			
1. Cili nga të poshtshënuarit jeni ju? (zgjidh një ose më shumë kuti)			
a. Krijuesi i mbetjeve		b. Grumbulluesi i mbetjeve	
2. Zotërues i lejes së mjedisit:			
Tipi i lejes së mjedisit (A, B) e: krijuesit grumbulluesit		a. Numri i lejes së mjedisit të krijuesit b. Numri i lejes së mjedisit të grumbulluesit	

3. - Emri i personit fizik/juridik që është krijues i mbetjeve (me shkronja të mëdha shtypi); - Adresa dhe numri i NIPT-it; - Nënshkrimi i personit përgjegjës (emri, mbiemri, firma); - Data e nënshkrimit.	
4. - Emri i personit fizik/juridik që është grumbullues i mbetjeve (nëse ka); - Adresa dhe numri i NIPT-it; - Nënshkrimi i personit përgjegjës (emri, mbiemri, firma); - Data e nënshkrimit.	
5. - Emri i personit fizik/juridik që është agjent ose tregtar i mbetjeve (nëse ka); - Adresa dhe numri i NIPT-it; - Nënshkrimi i personit përgjegjës (emri, mbiemri, firma); - Data e nënshkrimit.	
6. Transportues i licencuar për mbetjet (nëse ka); (Emri i personit fizik/juridik me SHKRONJA TË MËDHA SHTYPI dhe numri i NIPT-it).	
Nëse ka licencë III.2.B, numri i licencës	
Nr. i regjistrimit të automjetit (targa)	
Nënshkrimi i transportuesit	
Data e nisjes	
Ora e nisjes	

Seksioni B. Përshkrimi i mbetjeve (për t'u plotësuar nga krijuesi)									
1. Përshkrimi i mbetjeve:									
2. Kodi i Katalogut Shqiptar të Mbetjeve:									
3. Sasia e mbetjeve (e shprehur në kg ose në litër):									
4. Ku ruhen apo magazinohen mbetjet									
Të hapura		Në thasë		Në kosh metalik të hapur		Në kontejner metalik cilindrik		Në cisternë	
Të tjera (lutemi përshkruajini):									
5. Numri i thasëve, kontejnerëve, koshave, cisternave e të tjera:									
6. Pesha e thasëve, kontejnerëve, koshave, cisternave e të tjera:									

Seksioni C. Personi që merr në dorëzim mbetjet (pritësi)	
1. Emri i plotë (SHKRONJA TË MËDHA SHTYPI)	

2. Emri - adresa dhe numri i NIPT-it të kompanisë			
3. Tipi i lejes së mjedisit (A, B):		Numri i lejes së mjedisit	
4. Nr. i licencës III.2.B			
4. Nënshkrimi i pritësit (emri, mbiemri, firma)			
5. Data e marrjes në dorëzim			
6. Për t'u plotësuar nga pritësi në rast refuzimi të pjesshëm ose të plotë të mbetjeve			
Arsyet e refuzimit:			
Kodi i mbetjes së refuzuar sipas Katalogut të Mbetjeve			
Sasia e mbetjes/eve të refuzuar/a			
Data e refuzimit dhe nënshkrimi (emri, mbiemri, firma)			
7. Për t'u plotësuar nga personi që merr mbrapsht mbetjet e refuzuara (krijuesi/grumbulluesi/tregtari/agjenti)			
Data dhe ora e marrjes në dorëzim të mbetjeve të refuzuara			
Nënshkrimi (emër, mbiemër, firmë)			
Seksioni D. Destinacioni i mbetjeve (për t'u plotësuar nga pritësi)			
1. A shkojnë mbetjet për: (plotësoni vetëm një kuti)			
Rikuperim (jepni numrin R nga aneksi II, i ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve")			
Lendfill (D 5)			
Incinerim (D 10)			
Operacione të tjera asgjësimi (jepni numrin D nga aneksi I, i ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve")			

Seksioni C. Deklarata e paratrajtimin (për t'u plotësuar nga pritësi)									
Vendimi nr. 452, datë 11.7.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për lendfillin e mbetjeve", përcakton trajtimin si: proces fizik, termik apo biologjik (përfshirë seleksionimin) që ndryshon karakteristikat e mbetjeve, me qëllim pakësimin e vëllimit apo të natyrës së rrezikshme të tyre, lehtëson trajtimin apo rrit rikuperimin e tyre.									
Pjesa C plotësohet vetëm në rastet kur mbetjet asgjësohen në lendfill.									
1. Cilat materiale janë veçuar nga këto mbetje (vendosni shenjë √ në kutitë e duhura)?									
Letër		Karton		Metale		Qelq		Plastikë	
Dru		Ushqim		Të kompostueshme		Mbetje nga pajisje elektrike elektronike		Bateri	
Të tjera									
2. Cila është përqindja e vëllimit original total të mbetjeve që janë asgjësuar?									
Më pak se 5%				5% deri në 25%					
25% deri në 50%		50% deri në 75%		Më shumë se 75%					
Cilat procese janë përdorur për të ndarë apo për të trajtuar këto mbetje apo informacione të tjera që mund të ndihmojnë në trajtimin apo në asgjësimin e mbetjeve?									
Nëse mbetjet nuk janë trajtuar, lutemi deklaroni përse:									

--

Seksioni D. Vendi i transferimit	
1. Adresa e vendit të transferimit/pikës së grumbullimit:	
2. Data e transferimit:	
3. Koha e transferimit (për transferimet e shumëfishta, jepni datat e ndërmjetme)	

Aneksi 2

Metodologjia e përcaktimit të kodit unik të dokumentit të transferimit

(ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020)

Kodi unik i dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme përbëhet nga dy pjesë:

A. Pjesa e parë e Kodit Unik përmban 7 karaktere, nga të cilat 3 të parat janë shkronja dhe pjesa tjetër janë numra natyrorë. 3 shkronjat e para janë inicialet e personit fizik ose juridik ose akronimi i emrit të subjektit. 4 numrat fillojnë me 0001 për subjektin që kërkon i pari pajisjen me kodin unik. Më pas vazhdohet me vendosjen e numrave në rend rritës: 0002; 0003; e në vazhdim.

Shembuj:

a) nëse personi i parë që kërkon pranë MTM-së të pajiset me kodin unik është z. Elmaz Kujtim Latifi, pjesa e parë e kodit unik do të jetë: EKL0001;

b) nëse personi i dytë që kërkon pranë MTM-së të pajiset me kodin unik është subjekti “General Equipments Albania”, pjesa e parë e kodit unik do të jetë: GEA0001.

B. Pjesa e dytë e Kodit Unik përmban 4 numra, nga të cilët, 2 numrat e parë tregojnë vitin në të cilin kryhet transferta dhe 2 numrat e tjerë tregojnë numrin e transfertës që po kryhet. Pjesa e dytë e kodit unik vendoset nga vetë transferuesi i mbetjeve.

Shembuj:

- nëse personi i shembullit “a”, më lart, transferon mbetjet më datë xx.xx.2014 dhe është transferta e parë për vitin kalendarik 2014, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1401. Kodi Unik në këtë rast do të jetë: EKL00011401;

- nëse personi i shembullit “a”, më lart, transferon mbetjet më datë xx.xx.2014 dhe është transferta e dytë për vitin kalendarik 2014, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1402. Kodi unik në këtë rast do të jetë: EKL00011402;

- nëse personi i shembullit “b”, më lart, transferon mbetjet më datë xx.xx.2015 dhe është transferta e parë për vitin kalendarik 2015, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1501. Kodi unik në këtë rast do të jetë: GEA00011501;

- nëse personi i shembullit “b”, më lart, transferon mbetjet më datë xx.xx.2015 dhe është transferta e dytë për vitin kalendarik 2015, pjesa e dytë e kodit unik do të jetë: 1502. Kodi unik në këtë rast do të jetë: GEA00011502.